

THE MENTIONING OF THE ILLYRIAN-ARBËRESH AND THEIR ILLYRIAN-ARBËRESH LANGUAGE IN SOME SOURCES PËRMENDJA NË DISA BURIME TË ILIRO-ARBËRESHËRVE DHE GJUHËS SË TYRE

Jeton SALLAHU¹

¹ High School - Gymnasium „Egrem Çabej” – Vushtri, Republic of Kosova

*Corresponding author e-mail: jetonsallahu@hotmail.com

Abstract

The study we have prepared is entitled “Mention in some sources of the Illyrian-Arbëresh and their Illyrian-Arbëresh language”. This means that over the centuries we have identified some moments that have mentioned the parents of today’s Albanians, Illyrian-Arbëresh and the language spoken by them, Illyrian-Arbëresh, and of course all this has been valid for the region of today’s Vushtrri. Also, we have tried to prove that the “warning” made by academician Mark Krasniqi about the possibility of the existence of Albanian documents, respectively Illyrian-Arberian, from the 5th century, have nothing to do with the language, the culture of Illyrian-Arberian, but with another Asian people. This does not mean that there are no Albanian documents, respectively Illyrian-Arberian written from the 5th century, however, those that have been “warned”, as we just mentioned, do not have to do with the Illyrian-Arberians of the Ballkans.

Keywords: *Written sources, Illyrian-Arbëresh, Illyrian-Arbëresh, culture, today’s Vushtrri region.*

Përmbledhje

Studimi që kemi përgatitur titullohet “Përmendja në disa burime të iliro-arbëreshëve dhe gjuhës së tyre iliro-arbërishtes”¹¹³. Kjo do të thotë se nëpër shekujë kemi evidentuar disa momente që janë përmendur prindërit e shqiptarëve të sotëm, iliro-arbëreshët dhe gjuha e folur nga ta, iliro-arbërishtja, e që natyrshëm e gjithë kjo ka vlejtur edhe për rajonin e Vushtrrisë së sotme. Njashtu, jemi munduar të provojmë se megjithatë, “paralajmërimi” që kishte bërë akademik Mark Krasniqi rreth mundësisë së ekzistimit të dokumenteve shqipe, respektivisht iliro-arbërore, nga shekulli V, nuk kanë të bëjnë me gjuhën, me kulturën e iliro-arbërorëve, por kanë të bëjnë me një popull tjetër aziatik. Kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë dokumentet e shqipes, respektivisht iliro-arbërishtes së shkruar nga shekulli i V, megjithatë, ato për të cilat janë “paralajmëruar”, siç sapopërmendëm, nuk kanë të bëjnë me iliro-arbërorët e Ballkanit.

Fjalët kyçe: *Burime të shkruara, iliro-arbëreshët, iliro-arbërishtja, kultura, rajoni i Vushtrrisë së sotme.*

¹¹³ Autori i këtij shkrimi, me vetëdije, diku ka përdorur emrin *Arbër*, e diku *Arbëresh*, por që ka të bëjë me identifikimin e të njëjtit popull, porse që nëpër burime hasët këtyllëshëm.

I

Autori që në fund të viteve të 60-ta të shekullit XX, i cili kishte fituar *Çmimin e Pulizerit për Letërsi*, Will Durant, në fillim të librit të tij të titulluar *Mendjet dhe idetë më të mëdha të të gjithë kohëve*, shkruante, parafrazoj: “Nëse njeriu ka fat, para se të vdes do të mbledhë sa më shumë që të mundet pasuri të trashëguar të civilizimit dhe do t’ua bartë fëmijëve...”¹¹⁴, pra kjo do të thotë se atë pasuri kulturore që e ka njeriu, duhet t’a ruaj, t’a kultivoj, të jetë mirënjohës që e ka dhe mund t’a bartë atë, ngase kësajsojshëm mund të gjalloj për kohë të gjatë, dhe të shërbej si **përparim për një popull dhe jo vetëm**, në të kundërtën, nëse kjo nuk ndodhë, askush nuk mund të siguroj që kultura apo civilizimi i caktuar mund të rroj afatëgjatësisht, kështu na vie në “ndihmë” mendimi i historianit të madh anglez, H.A.L. Fisher, që shprehej, parafrazoj: “...përparimi nuk është ligj i natyrës, atë që ka arritur një brez, mund t’a humbas përsëri brezi tjetër...”¹¹⁵ (megjithëse ndonjë shtresë kulturore nëse nuk humb fare, “shtresa e mëhershme mund të qet pipa... ndërkohë”, por jo gjithënjë, J.S.).

Këtej, në kulturësferën shqiptare, qysh në fillim të viteve të 70-ta të shekullit XX, përfaqsonjësit nga trevat shqiptare dhe jo vetëm, ishin dakorduar që të kenë një **Gjuhë Standarde**, e cila do t’shërbente për komunikim më të mirë midis tyre (që u vë ajo së aplikuari) dhe do t’a unifikonte kombin shqiptar, që ky i fundit pa dëshirën e tij jetonte i ndarë në Ballkan. Natyrisht, gjuha duke qenë e gjallë, e jo statike, pasurohet vazhdueshëm me risi, dukuri kjo që duhet të ketë ndikim edhe në **Gjuhën Standarde**. Por, kjo nuk do t’thotë se duhet të krijohen *dy gjuhë të ndara shqipe*, siç bëjnë ca zëra të pakët, por që dijnë të “zhurmojnë” jo pak.

Ç’është e vërteta ajo që do të *ndalëm* këtu ka të bëjë me një shkrim “paralajmërues” të akademikut Mark Krasniqit, që mund të na shtyj të “shkojmë” më thellë në kohë. Natyrisht, kjo nuk do të jetë *ndalesa e vetme*, sidoqoftë, po ndalemi fillimisht te shkrimi në fjalë. Këtej, libri i Alberto Straticos, i titulluar *Manuale di letteratura albanese* që flet për “kulturën e iliro-arbërorëve në shekujtë V dhe VII”, janë vështirë të besueshme që kanë të bëjnë me kulturën e vërtetë të iliro-arbërorëve të Ballkanit të shekujve V dhe VII. Sidoqoftë, para se të flasim për këto të dhëna më shumë, sikur e do rendi paraprakisht të zgjatemi për historikun e gjuhës ilire ballkanike të para shekujve V dhe VII, që aplikohej nga paraardhësit e shqiptarëve të sotëm, ilirët!

Siç dihet e pranohet gjithëandëj në shkencë, civilizimet e para ishin krijuar në Lindje, ndaj ndikimet e para kulturore të asaj pjese, derdhën më vonë në Perëndim, me ç’rast me kalim të shekujve janë krijuar identitete heterogjene e pastaj ishin krijuar edhe identitetet e veçanta, e ndër këto identitete bënë pjesë pjesë edhe **Identiteti Ilir**, (që zuri formim të veçantë rreth kohës së bronzit), apo ndoshta fillimisht më mirë t’a quajm *identiteti protoilir*, e me kalimin e kohës duke e kompaktësuar atë (identitetin) e dalluar nga të tjerët, si fjala vjen nga grekët, t/thrakasit, romakët, apo ndonjë tjetër, u sforcua **Ilirizmi**, anipse edhe brenda vetë botës ilire duke ekzistuar fise të shumëta, kishin edhe ato *pjesët dalluese nga njëra tjetra* (njashtu me thrakasit kishin pikëtakime kulturore, ndaj edhe ndonjë studiues kur flet për ilirët, e përdorë formën *iliro-thrakas*, si fjala vie studiuesi i njohur shqiptar, Muhamet Tërnavë, madje ky i fundit mendon se pas disa gjeneratash thrakasit ishin asimiluar në iliro-arbnesh¹¹⁶).

¹¹⁴ Will Durant, *Mendjet dhe idetë më të mëdha të të gjithë kohëve* (Gatitur nga John Little, Titanic), p.p.5-9.

¹¹⁵ Karl R.Popper, *Mendime për historinë dhe politikën* (Gatiti-përktheu Gaqo Karakashi, Plejda), p.18.

¹¹⁶ Intervistë me studiuesin, profesorin Muhamet Tërnavë, i cili tashmë ka mbyllur sytë (Prishtinë, më 06.05.2017); Albanologu italian, Carlo Tagliavini, thoshte se gjuhësia rumune nuk mund të mësohet dhe të bëhet pa studimin e shqipes, për më shumë, shih: Ishtvan Schutz, *Hulumtia albanologjike në Universitetin e Shkencave të Budapestit në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 20/1, Prishtinë, 2002), p.p.135-140.

Ndërkohë, këto fise filluan të përbashkohen, kur njëri ndër ato fise përmes forces e impononte ndikimin e vet, apo “lidheshin” me dëshirë, duke krijuar *Federatë Fisesh*, që u paraprinte *Shteteve/Mbretërive Ilire*, këto të fundit zunë fillësë rreth shekujve V-IV p.l.k. Tani shtrohet pyetja, ç’gjuhë fliste ky popull? Historiani i njohur Kristo Frashëri në librin e tij të titulluar *Historia e qytetërimit shqiptar*, rreth kësaj çështje, shkruante, parafrazoj: “Tipar dallues i ilirëve ishte gjuha e tyre e mëvetsishme-*ilirishtja*, por tekst të shkruar të plotë ende nuk është gjetur, ndaj nga ajo dim, disa fjalë, qindra emra njerëzish, perëndish, vendesh e lumenjsh”.¹¹⁷

Këtë konkludim madje e pranon edhe historiani që lindi në Zvicrrës, Oliver Jens Schmitt, i njohur si historishkrues i paanshëm, gjersa të një pjesë e “miletit” njihet si historishkrues antishqiptar! Fjalën e kemi për dy librat e tij që ne i posedojm, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike dhe Shqiptarët një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Në librin e parë të sapopërmendur, në faqe 98, Schmitt, shprehët, parafrazoj: “Shqipja është një gjuhë indoevropiane dhe e vjetër ballkanike, për këtë ekziston konsensus në shkencë”.¹¹⁸ Ndërsa, në librin e dytë, në faqe 41, i njejtë autor, shprehët, parafrazoj: “Shqipja është një gjuhë e vjetër ballkanike”.¹¹⁹

Tutje, studiuesi nga Budapesti, Ishtvan Schutz, në punimin e tij të titulluar *Shkenca të ndryshme dëshmojnë lashtësinë e shqipes*, liston përmbledhtas elementet që dëshmojnë lashtësinë e shqipes, si, huazimi i shqipes të disa fjalëve nga greqishtja e vjetër, përdorimi në shqip të numrave **njëzet**, **dyzet**, tutje, në formë dialektore, **katërzet**¹²⁰, **trezet**,¹²¹ huazimi i shqipes të fjalëve nga latinishtja, si fjala vjen **dita e diel**, (*dies solis*, latinisht), marrë nga kalendari romak nga koha pagane, pra huazim ky edhe para se të përhapej krishterizmi në Gadishullin Ballkanik, gjersa gjuhët neolatine kanë marrë emrin latin të ditës në fjalë, ashtu siç e kanë përdorur të krishterët e parë, si, *domenica* (italisht), *dimanche* (frengjisht), *domingo* (spanjollisht), *duminica* (rumanisht), e tjerë.¹²²

Në fakt, numri i studiuesve të huaj që përkrahin këtë çështje është i madh, por për t’mos i përmendur me radhë, ia vlenë të përmendim një botim përmbledhës të disa punimeve të gatitura e të përkthyer nga Nelson R. Çabej, me titull *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*.¹²³ Tani, shtrohet pyetja, nëse gjuha ilire-prindëreshë e gjuhës shqipe, është kaq e vjetër, si u bëka që i mungojn shkrimet e bollëshme të saj në kohën e antikitetit?! *Së pari*, nëse pranohet se ilirishtja ishte folur nga prindërit e shqiptarëve të sotëm-ilirëve, kjo nuk do të thotë automatikisht se s’ka pasur edhe gjuhë të shkruar ilire, por thjeshtë shkrimet e plota në gjuhën ilire ende mund të mos jenë gjetur, kjo vërtetohet nga fakti i atyre që i shkrojtëm më sipër-disa fjalë të gjetura, emrat e njerëzve, perëndive, vendeve, lumenjëve e tjerë;

¹¹⁷ Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar nga kohët e lashta deri në fund të luftës së dytë botërore* (ASHSH, Tiranë, 2008), p.p.33-34

¹¹⁸ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (Gatitur-përkthyer nga Enver Robelli, Koha, Prishtinë, 2012), p.98.

¹¹⁹ Oliver Jens Schmitt, *Shqiptarët një histori midis Lindjes dhe Perëndimit* (Gatitur-përkthyer nga Ardian Klosi, K dhe B, Tiranë, 2012), p.41.

¹²⁰ Ishtvan Schutz, *Shkenca të ndryshme dëshmojnë lashtësinë e shqipes në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 20/1, Prishtinë, 2002), p.p.49-50.

¹²¹ Idriz Ajeti, *Shqipja e vështuar nga aspekti i studimeve ballkanistike në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 20/1, Prishtinë, 2002), p.22.

¹²² Ishtvan Schutz, *Shkenca... opcit*, p.p.50-51; Rreth disa adaptimeve të huazuara nga latinishtja në gjuhën shqipe, shih: Aleksej Sitov, *Disa vëzhgime mbi veçoritë e adaptimit të huazimeve latine në sistemin foljor të gjuhës shqipe në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Universiteti i Kosovës në Prishtinë-Fakulteti Filozofik, 12, Prishtinë, 1987), p.p.123-126.

¹²³ Nelson R. Çabej, *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane* (Rilindja, Prishtinë, 1990).

Së dyti, fakti se dikur ekzistonin shumë fise ilire, mbi 70 sosh (përfshirë edhe ilirët Dardan, që në antikitet së bashku me disa fise të tjera më të imëta ilire e kishin populluar Dardanië/Kosovën e sotme, e pra edhe rajonin e Vushtrisë së sotme) ka bërë që ilirët për një kohë jo të shkurtër kohore, *duke u marrë veshë mes vete*, ndoshta “nuk kanë pasur nevojë të shkruajnë”! Por, kjo çështje ka mundur të ndryshoj kur ka filluar formimi i *Federatave Fisnore*, e veçanarisht kur kanë filluar formimi i *Shteteve Ilire*, anipse *kolonizimi grek*, siç duket ka mundur të ketë ndikim edhe tek kultura ilire, do të thotë edhe në mendësinë e shkrimit, duke u n’varur në masë nga ajo. Megjithatë, ndoshta së paku në njëren nga shtetet ilire ka mundur me pasë ndonjë konsolidim rreth idesë së shkrimit në gjuhën amëtare, porse ndoshta humbja e gjurmëve të tij mund të ketë ndodhur gjatë dëmeve që kanë mundur të pësojnë nga zhvillimi i luftërave;

Së treti, pushtimi i një pjese jo të vogël të Ilirisë nga romakët, duke zënë fillësë nga shekulli III p.l.k., të pushtuar pastaj edhe pjesët tjera ilire gjer në shekullin e I p.l.k., apo të ripushtuara disa pjesë që kishin ngritur krye, kishte bërë që pushtonjësi të impononte gjuhën e tyre-latinishten, popullit vendës, ilirëve (megjithëse ilirët, dhe popujtë e tjerë në Ballkan, në të folur me gjasë kanë aplikuar një *latinishte popullore*¹²⁴), dhe ky i fundit pra e kishte të vështirësuar të shkruarit në gjuhën amëtare-n’ilirisht, derisa kjo e fundit në formë të folur ishte ruajtur brenda familjeve ilire, meqenëse aty kishte pasur hapësirë më të madhe kultivimi; Së katërti, megjithatë, *mesapishtja* si gjuhë antike e bartur në jug të Italisë nga Ballkani, është e lidhur me ilirishten ballkanike,¹²⁵ përçka pajtohen studiuesit e huajë, si, E. Hamp, apo vendës, si, Eqrem Çabej, Rexhep Ismajli, e të tjerë, e pra edhe kjo deridiku na provon ekzistimin e gjuhës së shkruar ilire, anipse siç edhe e kemi përmendur më lartë, për t’u bërë “boll”, duhen ende dëshmi.

Përveç këtyre që u tha, duhet thënë se kohët e fundit kanë dalur edhe plotë botime të tjera që elaborojnë “shkrimin e ilirishtës në antikitet”, porse meqenëse ende nuk janë të pranuar në shkencë, nuk po zgjatemi së trajtuar më tepër. Pra, meqenëse ilirishtja ishte përdorur ndër ilirët, ajo ishte përdorur edhe ndër ilirët Dardan, në Dardani/Kosovën e sotme, e pra edhe në rajonin e sotëm të Vushtrisë. Këtej, është interesant mendimi i studiuesit R. Katçiq, që thoshte, parafrazoj: “...fakti se shqipja flitet sot aty ku dikur ishte territor ilir, mund të themi se ajo është forma më moderne e ilirishtës...”.¹²⁶ Megjithëse, duhet shtuar se edhe shqipja gjatë historisë së saj, duke pasur kontakte me gjuhët e tjera, ndikimet reciproke i kanë ndodhur edhe asaj, në formën “dhënie marrje”, siç e përmendëm edhe më sipër.

Tani, duke u rikthyer tek shkrimi i akademikut Krasniqi, të cilit i kishte rënë në dorë libri i priftit kroat, Lovro Mihačević, lindur në Kreshevë të Bosnjës dhe i cili kishte qëndruar ndër shqiptarët për disa vite kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, dhe i cili kishte vlerësuar lartë kulturën shqiptare, fjalën e kemi për librin e titulluar *Po Albaniji-Dojmovi s puta*, që shqipërisht përkthehet *Nëpër Shqipëri-Përshtypje nga udhëtimi*. Këtej, ajo që ka një rëndësi të veçantë është fakti se në librin e autorit kroat përmendët: **dokumentet e para të letërsisë shqipe datojnë nga shekulli V, që kanë të bëjnë me ligje, rregulla të shkruara për klerikë dhe laikë, kurse nga shekulli VII, ekziston një pjesë e elegjisë mbi vdekjen e sundimtarit Tehervantiherit.**

¹²⁴ Idriz Ajeti, *Shqipja e vështruar...* opcit, p.21.

¹²⁵ Studiuesi Klodian Gjoni, për *mesapishten* thotë se nga baza arkeologjike dëshmohet si degë e ilirishtës, apo në njëfarë mase si një dialekt i saj, pastaj i zhvilluar për shekujë në kushte veçimi nga trugu i saj gjuhësor kryesor, për më shumë shih punimin e tij të titulluar *Mbishkrimet dhe rëndësia e tyre në Kumtesat I shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike “java e shkencës”* (Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë, Prishtinë, 2013), p.p.449-452.

¹²⁶ Rexhep Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe* (Rilindja, Prishtinë, 1987), p.p.24-26; Njohësi i thellë i ilirëve, Aleksandër Stipčević, në librin e tij *Ilirët, historia, jeta dhe kultura* (Rilindja, Prishtinë, 1980), p.p.239-244, megjithëse nuk përjashton *gjuhën e shkruar ilire*, porse ai e vënë në dyshim nëse Linguistika Bashkëkohore e pranon *Mesapishten* si gjuhë ilire.

Mirëpo, meqenëse libri nuk kishte fusnota, ndaj nuk dihej saktë të shpjegohej se nga i nxori këto informacione prifti kroat, porse dyshimi lindi se ato (shkronjat e më sipërta me ngjyrë t'zezë) u morën si referencë nga autori Alberto Stratico, respektivisht nga libri i tij *Manuale di letteratura albanese* (Ulrico Hoepli, Milano, 1896), ngase këtë të fundit, autori kroat e kishte përmendur në librin e tij, dhe shton se aty ishte paisur me të dhëna.¹²⁷ Ç'është e vërteta dyshimi u hoç, ngase nga hulumtimi që i kemi bërë librit të prof.Stratico-s të shkruar në gjuhën italiane, të dhënat i kemi gjetur aty në faqet 44-56.¹²⁸ Njashtu duhet thënë se autorin Alberto Stratico-n e kishte zënë në gojë edhe albanologu Robert Elsie, në studimin e tij *Histori e letërsisë shqiptare*.¹²⁹ Tutje, edhe studiuesi Fadil Raka në librin e tij të titulluar *Historia e shqipes letrare*, faqe 68, duke e zënë në gojë librin e autorit kroat t'cilën e kishte botuar më 1909, thotë, parafrazoj: “Alfabeti Masrop i Masdotit-veç të cilit ekzistonte edhe një tjetër, rrjedhë nga shekulli V, e nga ky shekull n'a janë ruajtur edhe përmendoret më të vjetra të letërsisë shqipe...”!¹³⁰




Fig 1. Libri *Manuale di letteratura albanese* i autorit Alberto Stratico-s.¹³¹

¹²⁷ Mark Krasniqi, *Tradita shqiptare në veprën e një autori kroat në Çështje të studimeve albanologjike II* (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987), p.p.349-363. Njashtu, të njejtin shkrim nga i njejtë autor mund të gjendët në librin *Nga gurra e traditës* (Zëri, Prishtinë, 1991), p.p.392-405.

¹²⁸ Duke njohur ndonjë fjalë të “gjuhëve latine”, të mësuar *tak tuk* nga serialet latine, dikur përcjellur ato, apo kuptuar pakësa nga to, n’a u mundësua të ndalemi te pjesa që ne n’a u duhej për trajtim (prill, Vërrri/Vërrnicë e Vushtrrisë, prill 2020). Gjersa për përkthimin ndihmoi miku Vasil Nasaj nga Shqipëria Shtetërore, përkthyen profesionalisht, Edi Bello, dhe Guri Pashaj (Tiranë, prill 2020).

¹²⁹ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare* përkthyer nga origjinali anglisht *History of Albanian literature*, nga Abdurrahim Myftiu (1995, gjersa Tiranë më 1997, pa numër faqeje).

¹³⁰ Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare* (Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, 1997), p.68.

¹³¹ Marrë nga “Manuale di letteratura albanese: Stratico, Alberto, archive.org/details/straticoletteraturaalbanese” (parë për të fundit herë më 18.04.2020).

Por cila është e vërteta rreth këtyre dokumenteve?! Mesrop Mesdoti kishte qenë një gjuhëtar armen, i cili kishte luajtur rol në zhvillimin kulturor armen, madje ai kishte kompozuar një *alfabet armen*, dhe më vonë për nder të tij, ai alfabet u quajt *Mesropia*. Gjersa shkruarja e tij në Albani, nuk ka të bëjë me gjasë me Albaninë/Shqipërinë e Ballkanit, por me atë të Azisë, sikurse përpilimi i një *alfabeti për shqiptarët* me shkronja armene, nuk ka të bëjë me një alfabet për iliro-arbërorët-prindërit e shqiptarëve të sotëm, por me albanët e Azisë.

Tutje, edhe *teksti i ligjeve të para shqiptare* të shekullit 5, të cilat kanë të bëjnë me sanksione legjislative të kishës albane, të ekzistencës së klasës së burrave të lirë, të ekzistencës së klasës së aristokratëve të lartë, të përbërë nga familja mbretërore, të gëzimit të privilegjeve të shumëta të klerikëve në krahasim me qytetarët e tjerë, megjithëse edhe kleri i nënshtrohej disiplinës së rreptë dhe i përgjigjegj Kryepeshkopit dhe Mbretit, pastaj, specifikimi i dispozitave në lidhje me detyrat e qytetarëve, që kishin të bëjnë me marrëdhëniet familjare dhe sociale, megjithëse edhe këto nuk dihet me saktësi a ishin shkruar në albanishten aziatike apo në atë armene, pra gjasisht **nuk kanë t’bëjnë** me iliro-arbërishten ballkanike. Përveç këtyre që u përmendën, është po ashtu edhe *një fragment kënge elegjike* që ndërlidhet me shekullin e VII, që duhet të sqarohet.

Fjala është për vitin 661, që ishte sjellur një këngë nga Mose/Moisi Galgantuni, me rastin e vdekjes së Princit Tehevantcher. Në fakt, ky ishte vlarë nga një komplot në derën e pallatit të tij. E meqenëse ai ishte vlerësuar trim, i matur, i mençur, rivendosës i monarkisë, vulosës i lirisë albane, ndaj populli e çmonte. Kështu, kur vdiç ai, kishte prodhuar dhimbje të përgjithshme, ndaj ishin krijuar edhe këngë, e njëra ndër to ishte ajo e evidentuar nga prof Stratico në studimin e tij të sipërpërmendur. Këtej, Stratico e krahason atë me një moment që rrjedhi pasi vdiç heroi i vërtet i arbëro-shqiptarëve të Ballkanit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, dhe bashkombasi i tij, Lekë Dukagjini, me atë rast, shqyente flokët, tundte ballin dhe bërtiste: *Shkundni themelet, Shqipëri/Albani!*¹³²

Ç’është e vërteta çështja e Lekë Dukagjinit, merëzia e tij e shprehur në formën e sipërpërmendur me rastin e vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ka mbështetje burimore, porse krahasimi i këtij rasti, me atë të Tehevantcherit, nuk besoj që kanë të bëjnë me të njëjtën kulturë etnonacionale, porse këto janë kultura me formësime të ndryshme, shprehur si në manifestim, ashtu edhe në hapësirë gjeografie. Gjersa *e para* ndërlidhet me kulturën e arbëro-shqiptarëve të Ballkanit, të Evropës, *e dyta* ka të bëjë me një kulturë të një populli tjetër aziatik. Tani shtrohet pyetja, pse ky ngatërrim?!

Me saktësi nuk mund as ne të përgjigjemi, megjithatë, mund të përmendim se kishte pasë ekzistuar një mendim se shqiptarët e sotëm kanë ardhur në Ballkan nga Kaukazi (albanët e atyre anëve) në mesjetë, këtë mendim dikush e ka bërë pa ndonjë qëllim, e pra ku mbrapa saj nuk ka qëndruar politika, sikurse ka pasur edhe një mbështetje veçanarisht të atyre “studiuësve” që mbrapa u ka qëndruar politika, pra, për të përkrahur këtë teori, me synim që shqiptarët e sotëm mos të nxjerrën “venali”,¹³³ por të ardhur në Ballkan. Mirëpo, këtë teori, ka kohë që shkenca e ka hudhur poshtë, duke provuar vazhdimësinë e arbëro-shqiptarëve nga ilirët, gjersa emërtimet Alban, Albani, përveç që hasën në Azi, ato hasën edhe në kontinentet e tjera, apo edhe në disa vende të tjera evropiane, porse kjo nuk do të thotë se ekziston lidhja e tyre me albanët/shqiptarët e Ballkanit. Këtej, është me vend konstatimi i studiuesit Aleksandër Meksit, që thotë, parafrazoj: “...autoktonia e shqiptarëve, vazhdimësia e gjuhës dhe të qenurit e saj indoevropiane, vërtetohet nga shumë disiplina”.¹³⁴

¹³² Alberto Stratico, *Manuele di letteratura albanese* (Ulrico Hoepli, Milano, 1896), p.p.44-56.

¹³³ Vendës.

¹³⁴ Aleksandër Meski, *Shqiptarët dhe Albania e Kaukazit* marrë nga gazeta *Infopress* (më 22.04.2020).

I njejtj autor, ka elaboruar edhe çështjen e dokumenteve që ne kemi në trajtim, dhe se ka ardhur në përfundim se bëhet fjalë për dokumentet që kanë të bëjnë me kulturën e albanëve kaukazian, e nuk kanë të bëjnë me kulturën e iliro-arbërorëve ballkanas.¹³⁵ Sidoqoftë, përmendja e iliroarbërorëve nëpër burimet e shkruara është provuar deri në shekullin e VI, respektivisht me *Dëshmitë e Mirakula Sankti Demteri*¹³⁶ në shekullin e VII,¹³⁷ më pastaj ndoshta iliro-arbërorët mund të gjenden brenda emërimit *Romej/Romaius*, duke qenë pjesë e Perandorisë Romake, respektivisht Perandorisë Bizantine, nënshtetas të saj, apo kur ishte nën ndikimin e bullgarëve, mund të gjenden brenda emrit *Bulgaroi*,¹³⁸ gjersa ata do të ripërmenden edhe nga shekulli XI e tehu si të veçantë,¹³⁹ ndoshta se nga shekulli i fundit që e përmendëm, arbërorët duke u dalluar me luftërat e tyre, bien në sy më shumë, prandaj edhe përmenden më shumë (Mihal Ataliati, Ana Komnena).

Në këtë drejtim është interesant të përmendim mendimin e studiuesit Eqrem Çabej në pjesën diskutante, gjersa i përgjigjej kumesës *Mbi elementet autoktone të rumanishtës*, të studiuesit nga Bukureshti, Alexandre Rosetti,¹⁴⁰ i cili thoshte, parafrazoj: “Nomenklatura e lundërimit dhe e peshkatarisë, leksiku i shtazëve dhe i bimëve detare përmbanë jo pak elemente të vendit (Iliro-Arbërisë, iliro-arbërorëve, J.S.), tutje, emri *Albanoi* përmendur nga Ptolemeu, nuk është emër rasti, por rron si emër i vjetër i këtij populli, në *arbër*, *Arbëri*, pra është një dëshmi historiko-gjuhësore e një vazhdimësie.

Pastaj, përmendja e arbërorëve në shekullin e XI, pra *tek pas një kohe*, shpjegohet si rast i pamundësisë së organizimit të arbërorëve të një shteti të tyre (ngase ishin brenda Bizantit, J.S.), ndaj edhe nuk *ishin marrë n’sy nga shënuesit*, sikurse rëndom shënuesit lënë gjurmët e popujëve që pushtojnë, robërojnë, e jo fort atyre që pushtohen, robërohen...!”¹⁴¹ Njashtu, duhet përmendur faktin se gjetjet arkeologjike në truallin iliro-arbëror, siç n’a informon studiuesi Skënder Anamali, **provojnë praninë e iliro-arbërorëve në atë truall.**¹⁴²

E për këtë periudhë që po flasim, pra kalimin nga antika në mesjetë, është interesant punimi i hulumtuesve Helen Howe, Robert T. Howe, i titulluar *The medieval world*, që jep një tablllo të shkurtër, por koncize, të Perandorisë Romake, respektivisht Perandorisë Bizantine.¹⁴³ Në fakt, duhet shtuar se në vitet e fundit, ka qarkulluar edhe një studim i sjellur nga studiuesi i zunë në gojë më lartë, Robert Elsie, i cili n’a bënë të dyshojm se edhe në shekullin e X, apo n’fillim të shekullit XI, përmenden në burime arbërorët.

¹³⁵ Ibid.

¹³⁶ Skënder Anamali, *Ilirët dhe shqiptarët/Les Illyriens et les Albansais*, marrë në https://www.persee.fr/doc/Iliri_1 (parë për të fundit herë më 23.04.2020), p.p.14-15.

¹³⁷ Mathieu Aref, e përmend këtë, “Mirakula Sancti Demetri” të Selanikut, pra në shekullin e 7, për më shumë shih studimin e tij, *Shqipëria Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen* (Plejad, Tiranë, 2007), p.178; Skënder Anamali, *ibid*.

¹³⁸ Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI* (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1995), p.p.22-23.

¹³⁹ Krsito Frashëri, *opcit*, p.54; Jeton Sallahu, *Pështjellimi ballkanik dhe vazhdimësia iliro-arbërore në mesjetën e hershme*, në gazetën *Bota Sot*, e ndarë në katër pjesë, n’këtë rast bëhet fjalë për pjesën e tretë (Prishtinë, 21-25 janar 2015), p.19.

¹⁴⁰ Alexandre Rosetti, *Mbi elementet autoktone të rumanishtës në Konferenca e dytë e studimeve albanologjike III* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969), p.p.127-129.

¹⁴¹ Eqrem Çabej, *Diskutim rreth kumesës së A.Rosetit, Mbi elementet autoktone të rumanishtës në Konferenca e dytë e studimeve albanologjike III* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969), p.p.329-330.

¹⁴² Skënder Anamalo. *Ilirët...* opcit, p.16.

¹⁴³ Helen Howe, Robert T. Howe, *The medieval world* (Longman, London, Melbourne, Auckland, Toronto, New York, 1992), p.p.18-30.

Studimin në fjalë, e kemi hasur të titulluar *Texts and documents of Albanian History*, gjersa ka të bëjë me një *Fragment mbi origjinën e kombeve*, që mund të gjendët në një tekst bullgar, riprodhuar nga një manuskript çirilik (serb?) të vitit 1628 dhe i botuar më 1934 nga studiuesi Radosllav Grujiç, që përpiket të u shpjegohet origjina e popujëve dhe gjuhëve.

Kështu, dokumenti gjersa flet për popujtë, fetë, gjuhët, midis tjerash, përmend edhe **arbëro-shqiptarët si një popull apo grup gjuhësor**. Aty përveç tjerash, përmendën këta 12 popujë: Alamanians (Alamanët), Franks (Frëngët), Magyars (Hungarezët), Indians (Indoevropianët), Jacobites (Skocezët), Armenians (Armenët), Saxons (Saksonët), Lechs (Polakët), **Arbanasi (Albanians, Arbëro-Shqiptarët)**, Croatians (Kroatët), Hizi (Hizët), Germans (Gjermanët).¹⁴⁴ Po ashtu, me interes është të përmendët autori, historiani, që flet për **Themat në Arbëri**, njëkohësisht ishte perandor bizantin i shekullit X, Kostandin Porfirogjeneti, në veprën e tij *Mbi temat*, sikurse janë po ashtu me rendësi, edhe dy materiale që ishin përgatitur nga qeveritarët bizantinë, e që tërthorazi kuptojmë edhe për gjendjen në Arbëri. Materialet në fjalë, do zbatoheshin edhe në viset ballkanike të sunduara nga ata. Fjalën e kemi për *Ligjin agrar*, zbatuar në shekujtë VII-VIII, që trajton marrëdhëniet midis pjesëtarëve të një bashkësie, dhe *Statutin e tatimeve*, legjislacion financiar që rregullonte në shekullin e X marrëdhëniet fiskale midis bashkësisë fshatare dhe shtetit bizantin.¹⁴⁵

II

Gjatë fillimit të mijëvjeçarit të dytë, shkrimet rreth arbërorëve shpeshtohen. Kështu, ne do të ndalemi vetëm në *ngjarjet para dokumentit Formula e Pagëzimit të vitit 1462*. Këtej, këto ngjarje i shohim në shekullin e XI, pastaj në shekullin e XII me rastin e krijimit të *Shtetit të Arbërit*, dhe vazhdon në shekujtë vijues. Por, shënimet janë prezente edhe për *gjuhën arbërore*, më saktë këtë e shohim në shekullin e XIII. Fjalën e kemi për vitin 1285, gjersa na bënë të ditur studiuesi i popujve ballkanik, Konstantin Jeriçeku, i cili thotë se përmendja e *gjuhës arbërore/shqipe*, është gjetur në një akt të një procesi gjyqësor në Dubrovnik/Raguzë, rreth një vjedhje në Kasale (Casale), kryer nga Petar do Volci në Belen (Plati i sotshëm), në Zhup.

Dëshmitari Matheus, biri i Markut të Mençes, thotë: “Audivi unam vocem, clamantem in monte in lingua albanesca”,¹⁴⁶ që do të thotë, *ndjeva një zë që thërriste në mal në gjuhën arbërore/shqipe*.¹⁴⁷ Gjersa studiuesi Milan Shuflaj, duke folur për të njejtën ngjarje në studimin e tij të titulluar *Srbi i arbanasi* që shqipërisht i bie *serbët dhe shqiptarët*, në faqe 94 thotë, parafrazoj: “...malsorët shqiptarë mund të merrën vesh njëri me tjetrin me thirrje në largësi të madhe, nga mali në mal, e një bisedim i tillë vërtetohet në burimet e mesjetës (1285)...”.¹⁴⁸ Po si shpjegohet fakti se arbërishtja/shqipja u aplikua në rajonin e Dubrovnikut/Raguzës, që posa e zëmë në gojë?

¹⁴⁴ Robert Elsie, *Texts and Documents of Albanian History, 1000-1018 Anonymous, Fragment on the Originis of Nations* (parë për herë të fundit më 22.04.2020). Ndryshe zotëri Elsie ka dhanë aty edhe sqarimin referencës, duke treguar se ka marrë këto të dhëna nga autori Radoslav Grujiç, *Legenda iz vremena Cara Samuila o poreklu naroda*, in: *Glasnik skopskog naucnog drustva* (Skopje/Shkup, 13, 1934), p.198-200, gjersa zotëri Elsie e ka publiku fillimisht në *Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th-17th Centuries* (Wiesbaden, 2003), p.3; Edhe studiuesi shqiptar, Jahja Drançolli e ka publiku këtë dokument në rrjetin e tij *fejsbuk* (më 15 mars 2018).

¹⁴⁵ Përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo, *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë vëllimi II* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1962), p.p.5-6.

¹⁴⁶ Idriz Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës* në revistën *Gjurmime albanologjike seria e shkencave filologjike IV* (Insituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975), p.8.

¹⁴⁷ Eqrem Çabej, *Dy fjalë si hyrje në Studime gjuhësore VI* (Botimi i dytë, Rilindja, Prishtinë, 1988), p.8.

¹⁴⁸ Milan Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët* (Përktheu nga kroatishtja Hasan Çipuri, Toena, Tiranë, 2004), p.94.

Këtu është e udhës të përmendët mendimi i studiuesit Idriz Ajeti, i cili thotë, parafrazoj: “...masat kompakte shqiptare **afër Dubrovnikut** dhe **Kotorrit** që mund të shihen në shekullin e XIII, në fakt këtej ka pasur kudo edhe mbeturina autoktone ilire, të shpërngulura nga një bërthamë shqiptare...”¹⁴⁹ Një e dhënë tjetër historike që shkruan edhe për kulturën arbërore, është *një tekst latin mesjetar i vitit 1308 i një autori anonim*, respektivisht i ashtuquajtur *Anonymi Descriptio Europae Orientalis* (Përshkrimi Anonim i Evropës Lindore) sipas gjasave të një kleriku frëng të Urdhërit Domenikan, apo shkollat në Francë, që përshkruante vendet dhe popujt e Evropës Lindore, veçanti vendet e Ballkanit, ngase atë e kishte dërguar kisha për këtë punë-mbledhjen e të dhënave.

Këtej ai kishte lënë përshkrime edhe për gjuhën arbëro-shqiptare, citoj: “habent enim albanii prefati linguam distinctam a latinis, grecis et sclavis ita quod iu nullo se intelligunt cum aliis nationibus”,¹⁵⁰ që shqipërisht ka afërsisht këtë kuptim: *arbëro-shqiptarët kanë një gjuhë të dallueshme nga latinët, grekët dhe sllavët, kështu që kurrësi nuk mund të merren vesh me popujt tjerë!*¹⁵¹ Pas ca vitesh më vonë, më saktësisht në vitin 1322, kemi një të dhënë tjetër rreth *gjuhës arbërore/shqiptare*, më saktësisht këtë e bënë të ditur pelegrini anglezo-irlandez, Symon Semeonis, gjersa ishte duke udhëtuar me pelegrinin tjetër anglezo-irlandez, Hugo Illuminator në drejtim të “Tokës së Shenjtë” e që ishin nisur nga Irlanda.

Këto përshkrime *Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam* (Udhëtimi i Simon Simonit nga Irlanda në Tokën e Shenjtë), dorëshkrimorshëm ruhen në bibliotekën “Corpus Christi College” në Kembrixh, e që midis tjerash mund të gjenden shënime si, “Albanya est provincia inter Sclavoniam et Romanyam, per se linguam habens”, që shqipërohet, *Shqipëria është një provincë midis Sllavonisë dhe Romanisë (Bizantit), me një gjuhë të vetën*, apo, ai gjuhën e arbëro-shqiptarëve e përmend edhe në Dubrovnikë/Raguzë, “si gjuhë e barbarëve”!¹⁵²

Pak vite më vonë, më 1332, kemi një të dhënë prapë që dëshmon rreth përdorimit të *arbërishtës/shqipes së shkruar*, apo *librave arbërorë/shqiptarë*. Fjala është për librin latinisht *Directorium ad passagium faciendam*, e klerikut frëng, Brocardus Monacus, që shkruan: “Licet Albanenses aliam omnino linguam latinam habeant et diversam, tamen litteram habent in uso et in omnis suis libris”, që shqipërohet kështu: *Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre*”.¹⁵³ A do të thotë kjo se arbëro-shqiptarët kishin libra të shkruar para Mesharit të Buzukut, dhe se ky i fundit ka ndjekur një traditë shkruese paraprake, anipse ai qaj se nuk kishte diçka të tillë?!

Apo ndoshta “qarja e tij” ishte në kuptimin e *librave të shtypur*, gjersa mbishkrime në gjuhën arbëro-shqiptare, anale, kronika, tekste fetare mund të kishin ekzistuar, apo mos Brocardi e kishte fjalën për libra të shkruar në gjuhën latine?!¹⁵⁴ Këtej, po i përmendëm disa momente që lidhen me këtë çështje.

¹⁴⁹ Idriz Ajeti, *Kontribut...* opcit, p.7.

¹⁵⁰ Eqrem Çabej, *Dy fjalë...* opcit.

¹⁵¹ Robert Elsie, *Histori e letërsisë...* opcit.

¹⁵² Ibid.

¹⁵³ Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850* (Rilindja, 1978), p.p.27-28; Disa studiues thonë se ishte i njëjti njeri, Brocardi me Guiellmus Adae-n, arqipeshkv i Tivarit, disa thonë se ishte Brocardi që e shkroi fjalinë e mëlartë, porse i mvishej gabueshëm Adae-s, pra ishin të ndryshëm?! Rreth vitit të të dëshmisë së Brocardit, disa mendojnë se ishte gabim, ndonjë mendon se kur Brocardi përdori termin “litteram” e kishte fjalën për libër, e jo alfabet ose shkronjë, pra në kuptimin *shkruanin dhe kishin libra latinisht*, e disa i kishin ngatërruar edhe “Brocardët...”! Rreth të qenurit të ndryshëm të Brocardit dhe Adaes, shih punimin e Robert Elsie, *Histori...* opcit, fusnota numër 13!

¹⁵⁴ Dhimitër... opcit..

Në nëntor të vitit 1940, N. Borgia, në Grottaferata pranë Romës ia kishte kumtuar E. Çabejt se kishte pas **zbuluar një dokument në gjuhën shqipe** në Arkivin Vatikan, e që ishte më i vjetër se ai i Buzuku, mirëpo kjo fshehtësi u shkoi në varr së bashku me studiuesin.¹⁵⁵ Kjo n'a lënë të dyshojm rreth një tradite të shkruar në gjuhën arbërore-shqipe, mirëpo, *Çështjen Borgia* duhet hulumtuar mëtej, për të vërtetuar dokumentin që ai bënte fjalë!; Tutje, rreth vitit 1460, burrështetasi i Arbërisë, hero i popullit arbëror, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i dërgon një letër italisht, princit të Tarantos, Giovanni Antonio Orsinit, "...se le nostre croniche non mentino, noy ni chiamamo Epiroti...", që në gjuhën shqipe, do të thotë **sipas kronikave tona, ne quhemi epirotë**,¹⁵⁶ vazhdon letra, dhe duhet ta dini se në kohë të tjera, stërgjyshërit tanë kanë kaluar në vendin tuaj që ju mbani sot dhe kanë bërë me romakët luftime të mëdha dhe e dimë se më të shumtën e herës u ndanë me nder se me turp (fjalën e fitoreve e ka gjasisht nga koha e Pirros së Epirit, J.S.).¹⁵⁷

Nga kjo kuptojm dy gjëra, e para, rreth mundësisë së ekzistimit të shkrimeve në gjuhën arbëro-shqiptare para *Formulës së Pagëzimit*, dhe e dyta, rreth asaj se Skënderbeu e ndiente vetën pasardhës të epirotasëve, pra ilirëve, Pirros, do të thotë e ndiente vetën arbëror; Është me interes të përmendët edhe njoftimi i të diturit, Marin Barleti/Barleci, në studimin e tij *Rrethimi i Shkodrës*, i fillimshekullit XVI, i cili duke folur për **historinë e kahershme të qytetit të Shkodrës**, thotë, *na paten ra në dorë disa shkrime ma tepër fragmente se sa t'i quejsh anale, në të cilat flitej ma shumë për meremetimin që i banë këtij qyteti stërgjyshët tanë se sa për ndërtimin e tij... ishte shkruar aty, në gjuhën popullore...*¹⁵⁸ Kjo n'a bënë të mendojm se fjala e shkrimit, ishte në gjuhën që populli-iliro-arbërorët e flisnin, respektivisht, iliro-arbërishten!; Edhe *Kronika e Gjon Muzakës*, anipse është e shekullit XVI, ajo nxjerrë përshkrime për ngjarjet e më hershme, pra është burim i çmuar historic,¹⁵⁹ siç do të thoshte studiuesi Kolë Ashta, "kanë të bëjnë me shkrime arbërishte...".

Në fakt, përveç *kronikave* që mund të jenë me rendësi për traditën e kahmotshëm të shkrimit të arbërishtes, dhe atyre që u përmendën deri këtu, ndoshta duhet kushtuar vëmendje edhe më të madhe *kancelarive të princave arbanë*, që mund të hasën ndonjë gjurmë të shkrimit të arbërishtës, pastaj *burimi i akteve publike e private në Arbëri*, si testamente trashëgimie, marrëveshje tregëtarësh, regjistrime tokash etj.¹⁶⁰ Këtej, për tu zgjatur dhe pak e për të përmendur edhe *Kronikën e Janinës*, version i parë mendohet të ndërlidhet me vitin 1442, gjersa bënte fjalë për një sulm të arbëro-shqiptarëve mbi qytetin e Janinës më 1379, dhe në gojën e tyre vihet fjala "**rua**" (rova), që mund të jetë në arbërishten, "**ruaju**".¹⁶¹

Rreth *arbërishtës*, interesante janë t'i përmendim edhe dy ngjarje që ndërlidhën me sundimtarët venedikas. *I pari*, i takon vitit 1393, gjersa ishte shkruar një urdhër në Venedik, që të lajmërohet bajl-kapitani i Durrësit të zgjidhte gjashtë kalorës për ruajtjen e rendit publik në Durrës, e përveç kushteve tjera, *të dinë gjuhën arbërore*.

¹⁵⁵ Eqrem Çabej, *Dy fjalë...* opcit, p.12, shih fusnotën 29.

¹⁵⁶ Dhimitër Shuteriqi, *opcit*, p.p.33-34; Megjithatë, kur zëmë në gojë *kronikat tona*, nuk e dimë me saktësi nëse e kishte kuptimin rreth *kronikave iliro-arbërore*, apo rreth *kronikave që ishin në gjuhë të tjera që elaborojë kultura dhe historia e lashtësisë*, e që i dituri Pal Engjëlli, duke qëndruar ndonjëherë pranë Skënderbeut, ia kishte kumtuar këtij të fundit ato!

¹⁵⁷ Grup autorësh, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shekullit XV* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1967), p.80.

¹⁵⁸ Marin Barleti, *Rrethimi i Shkodrës* (Përktheu nga latinishtja, Henrik Lacaj, Vatra, Shkup, 2009), p.58.

¹⁵⁹ Alessandro Serra, *Shqipëria dhe Selia e Shenjtë në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut* (Shqipëruar nga "Redaksia Shqipe" pranë "Radio Vatikanit", tani "Vatican News", Drita, Prishtinë, 2018), p.9.

¹⁶⁰ Kolë Ashta, *Disa të dhëna mbi fjalën e shkruar të arbërishtes si periudhë e mesme e historisë së gjuhës shqipe në Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike III* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1969), p.p.141-142; Megjithatë, Arnold von Harffi më 1497, thoshte se arbëro-shqiptarët kanë një gjuhë me vete, por nuk mund të shkruhet, meqë nuk kanë një shkrim të vetin në vendin e tyre, për më shumë shih, E. Çabej, *Dy fjalë...* opcit, p.12.

¹⁶¹ Dhimitër... opcit, p.33.

I dyti, i takon vitit 1399, kur Venediku kishte lëshuar dokument për kontkapitanin e Shkodrës, Nikollë Polanin, që të kishte *një përkthyes*.¹⁶² Nga që u lartëthënë, mund të themi se edhe nga **aspekti gjuhësor**, kemi dëshmi rreth ekzistencës së një kulture të vazhdueshme të popullit shqiptar ndër shekujë në trojet e tija në Ballkan, e pra edhe në rajonin e Vushtrrisë së sotme. Këtej, brenda kësaj kulture, duhet shikuar edhe kontaktet me popujtë e tjerë, ngase edhe ne kemi *dhënë e marrë copëza kulturore*, veçanarisht Dardania/Kosova si qendër e Ballkanit, ndaj këtu nuk përjashtohet as rajoni i Vushtrrisë.

Këtej, me të drejtë në Stamboll të Turqisë, në një ligjeratë/seminar, studiuesi Bekir Karllëga, do të thoshte, parafrazoj: “Duhet me u ruajtë civilizimet e ndryshme, e jo me tentu me prezantu vetëm një civilizim.”,¹⁶³ e pra, edhe kultura shqiptare është pjesë e këtyre *civilizimeve të ndryshme*. E ndër elementet kryesore të kulturës shqiptare, është gjuha, ndaj është i drejtë mendimi i Çabejt, që thotë, parafrazoj: “Historia e gjuhës është historia e popullit që e flet atë”.¹⁶⁴



Fig.2. Në mes, studiuesi Bekir Karllëga, kolegja Blerina Bejtullahu, dhe autori Jeton Sallahu në Stamboll të Turqisë, 21.11.2019¹⁶⁵

¹⁶² Kolë...*opcit*, p.142.

¹⁶³ Bekir Karllëga, *Ligjeratë rreth civilizimeve* (Stamboll, e enjte, 21.11.2019).

¹⁶⁴ Murat Blaku, *Shkrime gjuhësore* (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2015), p.110.

¹⁶⁵ Foto e dërguar nga kolegja Blerina Bejtullahu, për ç'gjë e falënderoj (Stamboll, 21.11.2019).

Për të përfunduar, mund të themi se shqiptarët e sotëm që jetojnë në Ballkan, kanë disa mileniume histori dhe kulturë gjuhësore, do të thotë **kanë një vazhdimësi** së paku nga paraardhësit e tyre ilirët, e pra edhe **janë popull autokton**. Megjithatë, dokumentet e përmendura nga studiuesi Mark Krasniqi, gjasisht nuk kanë të bëjnë me gjuhën iliro-arbërore-shqipe, siç u munduam të provojmë në këtë punim. Zhvillimet historike e kulturo-gjuhësore që u munduam të i elaborojmë në këtë rast, përfshijnë edhe trevën e Vushtrrisë, trevë kjo që nodhët në Kosovën e sotme, respektivisht në ish Dardaninë e antikitetit.

Referencat

- [1]. Ajeti, Idriz, [2002], Shqipja e vështuar nga aspekti i studimeve ballkanistike në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 20/1”, Prishtinë.
- [2]. Ashta, Kolë, [1969], Disa të dhëna të fjalës së shkruar të arbërishtes si periudhë e mesme e historisë së gjuhës shqipe në “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike III”, Tiranë.
- [3]. Aref, Mathieu, [2007], Shqipëria odiseja e pabesueshme e një populli parahelen, Tiranë.
- [4]. Barleti, Marin, [2009], Rrethimi i Shkodrës, Shkup.
- [5]. Buda Aleks, Zamputi Injac, Frashëri Kristo, Pepo Petraq, [1962], Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, Tiranë.
- [6]. Blaku, Murat, [2015], Shkrime gjuhësore, Prishtinë.
- [7]. Çabej, Eqrem, [1988], Dy fjalë si hyrje në “Studime gjuhësore VI”, Prishtinë.
- [8]. Çabej, Eqrem, [1969], Diskutim rreth kumtesës së A.Rosetit, Mbi elementet autoktone të rumanishtës në “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike III”, Tiranë.
- [9]. Çabej, R. Nelson, [1990], Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Prishtinë.
- [10]. Durant, Will, Mendjet dhe idetë më të mëdha të të gjithë kohëve.
- [11]. Elsie, Robert, [1997], Histori e letërsisë shqiptare, Tiranë.
- [12]. Frashëri, Kristo, [2008], Historia e qytetërimit shqiptar nga kohët e lashta deri në fund të luftës së dytë botërore, Tiranë.
- [13]. Grup autorësh, [1967], Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shekullit XV, Tiranë.
- [14]. Gjoni, Klodian, [2013], Mbishkrimet dhe rëndësia e tyre në “Kumtesat I”, Prishtinë.
- [15]. Howe Helen, Howe T. Robert, [1992], The medieval world, London, Melbourne, Auckland, Toronto, New York.
- [16]. Ismajli, Rexhep, [1987], Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë.
- [17]. Krasniqi, Mark, [1987], Tradita shqiptare në veprën e një autori kroat në “Çështje të studimeve albanologjike II”, Prishtinë.
- [18]. Krasniqi, Mark, [1991], Nga gurra e traditës, Prishtinë.
- [19]. Popper, R. Karl, Mendime për historinë dhe politikën.
- [20]. Raka, Fadil, [1997], Historia e shqipes letrare, Tetovë.
- [21]. Roxeti, Alexandre, [1969], Mbi elementet autoktone të rumanishtës në “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike III”, Tiranë.
- [22]. Serra, Alessandro, [2018], Shqipëria dhe Selia e Shenjtë në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Prishtinë.
- [23]. Sitov, Aleksej, [1987], Disa vëzhgime mbi veçoritë e adaptimit të huazimeve latine në sistemin foljor të gjuhës shqipe, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë.
- [24]. Stratico, Alberto, [1896], Manuale di letteratura Albanese, Milano.
- [25]. Stipčević, Aleksandër, [1980], Ilirët, historia, jeta, kultura, Prishtinë.
- [26]. Shuflaj, Milan, [2004], Serbët dhe shqiptarët, Tiranë.
- [27]. Shuteriqi S. Dhimitër, [1978], Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850.
- [28]. Schmitt, Jens Oliver, [2012], Kosova histori e shkurtër e një treve qendërore ballkanike, Prishtinë.
- [29]. Schmitt, Jens Oliver, [2012], Shqiptarët një histori midis Lindjes dhe Perëndimit, Tiranë.
- [30]. Schutz, Ishtvan, [2002], Shkenca të ndryshme dëshmojnë lashtësinë e shqipes në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 20/1”, Prishtinë.
- [31]. Schutz, Ishtvan, [2002], Hulumtime albanologjike në Universitetin e Shkencave të Budapestit në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 20/1”, Prishtinë.
- [32]. Tërnavë, Muhamet, [1995], Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI, Prishtinë.